



Drejtuar: Agjencisë së Prokurimit Publik
Shëtitorja “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë.

Lënda: Për procedurën e prokurimit me objekt: “Mbikqyrja e punimeve e dy objekteve në infrastrukturën arsimore në qytetin e Tiranës për vitin 2017”

FORMULARI I NJOFTIMIT TE KONTRATES

- 1. Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Tiranë, Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tel/Fax: 04 256 799, E-mail: prokurimet@tirana.gov.al; Adresa e Internetit: www.tirana.gov.al;
- 2. Lloji i procedurës së prokurimit:** “*Kërkesë për Propozim*”
- 3. Objekti i prokurimit:** “Mbikqyrja e punimeve e dy objekteve në infrastrukturën arsimore në qytetin e Tiranës për vitin 2017”

Të kryhet prokurimi i fondit prej: **2.551.088** (dy milion e pesëqind e pesëdhjetë e një mijë e tetëdhjetë e tetë) **lekë pa TVSH**, vënë në dispozicion në Zbatim të Vendimit Nr.29 datë 05.04.2017 për “Një shtesë dhe disa ndryshime në Vendimin e Këshillit Bashkiak të Tiranës nr.84 datë 29.12.2016 për “Miratimin e programit buxhetor afat mesëm 2017-2019 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2017(i ndryshuar)” konfirmuar nga prefekti i Qarkut Tiranë me shkresën nr.prot.1564/3 datë 20.04.2017, në zbatim të VKB nr.49 datë 31.05.2017 ”Për një ndryshim në VKB nr.84 datë 29.12.2016 për “Miratimin e Programit Buxhetor, afatmesëm 2017-2019 dhe detajimin e buxhetit të bashkisë së Tiranës për vitin 2017” i ndryshuar”, konfirmuar nga prefekti i Qarkut Tiranë me shkresën nr.prot.2405/2 datë 14.06.2017, në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak të Tiranës nr.84 datë 29.12.2016 për “Miratimin e programit buxhetor afat mesëm 2017-2019 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2017”, konfirmuar nga prefekti i Qarkut Tiranë me shkresën nr.prot.154/3 datë 17.01.2017, me objekt: “**Mbikqyrja e punimeve e dy objekteve në infrastrukturën arsimore në qytetin e Tiranës për vitin 2017**”, të ndarë në lote si më poshtë vijon:

- Loti i parë: “Mbikqyrja e punimeve për objektin: ”Rikonstruksion i pjesshëm i shkollës së mesme të përgjithshme ”Andon Z. Çajupi”, me fond limit **1.536.587** (një milion e pesëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e shtatë) **lekë pa tvsh.**
- Loti i dytë: “Mbikqyrja e punimeve për objektin: ”Ndërtim i sallës së koncerteve, pranë Auditorit të Liceut Artistik ”Jordan Misja”, me fond limit **1.014.501** (një milion e katërbëdhjetë mijë e pesëqind e një) **lekë pa tvsh.**

4. Burimi i financimit: Buxheti i shtetit , Te ardhura **X**, Grante, donacione etj

Investim **X**, Shpenzim operativ

5. Afati per kryerjen e shërbimit për secilin lot:

- **Për Lotin e parë afati:** Nga momenti i lidhjes së kontratës së sipërrmarjes për zbatimin e punimeve deri në përfundimin e punimeve, afati 10 (dhjetë) muaj.
- **Për Lotin e dytë afati:** Nga momenti i lidhjes së kontratës së sipërrmarjes për zbatimin e punimeve deri në përfundimin e punimeve, afati 12 (dymbëdhjetë) muaj.

6. Data e zhvillimit të tenderit: 20/10/ 2017, ora 11: 00 vendi: Bashkia Tiranë
Website i APP-së: www.app.gov.al

7. Afati i fundit për pranimin e dokumentave: 20/10/ 2017, ora 11:00 vendi:
Bashkia Tiranë, Website i APP-së: www.app.gov.al